

Kontaktet e ATK-së

Nëse keni nevojë për më shumë informacione, ATK ju inkurajon që të shqyrtoni ligjet dhe udhëzimet administrative përkatëse. Këto janë në dispozicion në faqen e internetit www.atk-ks.org. Nëse nuk jeni në gjendje të gjeni përgjigje për pyetjet tuaja, stafi i ATK-së është në dispozicion për të ju ndihmuar, prandaj drejtohuni në zyrën më të afërta të ATK-së:



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

3. Obligimi për të paguar tatimin në kohë

Sipas Nenit 119 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj, prandaj në bazë të kësaj ATK pret nga ju që:

- Të paguani shumën totale të tatimit në datat e caktuara;
- Të paguani shumën totale të ndonjë bilanci të papaguar si rezultat i vlerësimit apo rivlerësimit;
- Të mbani dhe dërgoni në afat të caktuar të gjitha tatimet të mbajtura apo të mbledhura në emër të të tjerëve.

4. Obligimi për t'u pajisur me Numër Fiskal

- Para hapjes së biznesit duhet të pajiseni me numër fiskal dhe të përdorni këtë numër për të gjitha procedurat në lidhje me ATK-në;
- Nëse jeni të obliguar apo vullnetarisht dëshironi të deklaroni tatimin, jeni të obliguar të pajiseni me Numër Fiskal. Deklaratat tatimore shkarkohen vetëm me Numër Fiskal.
- Nëse jeni person jo rezident, subjekt i tatimit në përputhje me legjislacionin tatimor, të caktoni përfaqësuesin fiskal para se të filloni ndonjë aktivitet ekonomik në Kosovë.

Nëse ju nuk i përmbushni obligimet tuaja tatimore:

- Ligji mund të parashikojë ndëshkime dhe /ose interes
- Evazioni tatimor dhe shkeljet mund të implikojnë shkelje kriminale dhe në raste më serioze mund të ndërmerren veprime persekutive.



Telefonat:

NJTM : 038/200 346 41

Prishtina-1: 038/200-255-21

Prishtina-2: 038/200-255-02

Prishtina-3: 038/200-255-17

Prizreni: 029/244-963

Peja: 039/432-812

Ferizaj: 0290/321-668

Gjilani: 0280/326-967

Mitrovica: 028/590-667

Gjakova: 0390/330-021

Zyra Qëndrore: 038/200-250-17

Linja e përbashkët pa pagesë:



0800-80-800

Adresa: Këndi i rrugëve Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel & Fax: +381 (0)38 200 250 17 & 200 250 07
Email: info@atk-ks.org; Web: www.atk-ks.org

**TË DREJTAT DHE
OBLIGIMET E
TATIMPAGUESVE**

*Respektimi i ligjit tatimor është
përgjegjësi esenciale qytetare!*

Ky dokument është përgatitur për të përmbledhur dhe për të shpjeguar gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, të drejtat dhe obligimet themelore të tatimpaguesve në relacion me ATK-në dhe legjislacionin tatimor.

TË DREJTAT THEMELORE TË TATIMPAGUESVE

1. E drejta për t'u informuar, ndihmuar dhe dëgjuar

ATK do të ju trajtojë juve me mirësjellje dhe konsideratë në çdo kohë dhe në rrethana normale do të:

- Ndihmojë tatimpaguesit për të kuptuar dhe për të përmbushur detyrimet tatimore;
- Shpjegojë arsyet për vendimet e marra në lidhje me çështjet tuaja;
- Finalizoj kërkesat për rimbursim brenda 60 ditëve pas dorëzimit të kërkesës;
- Përgjigjet në pyetjet tuaja me shkrim brenda 15 ditë: pune
- Shqyrtoj çështjet urgjente në një afat sa më të shkurtër kohor;
- Jap mundësinë për të pasur këshilltarë të certifikuar ligjor apo tatimor gjatë ndonjë hetimi;
- Dërgojë, pas përfundimit të ndonjë kontrolli, procesverbalin relevant apo këshillë të shkruar për rezultatin e kontrollit si dhe arsyet për vendimet që ne kemi marrë;
- Dërgojë detajet se si është llogaritur vlerësimi.

Nëse besoni se kjo e drejtë e juaja nuk është respektuar, ju inkurajojmë të kontaktoni Avokatin e Tatimpaguesve:

E-mail: avokatitativpaguesve@atk-ks.org
Tel: +381 38 200 347 09

¹Nëse pyetja kërkon sqarim shtesë apo është e natyrës specifike, ATK do të ju kontaktoj për të marrë më shumë informata, me këtë rast përgjigja mund të vonohet më shumë se 15 ditë.

2. E drejta për trajtim të paanshëm, etik dhe profesional

ATK në rrethana normale do:

- T'u njoftojë 3 ditë më herët për kryerjen e ndonjë interviste, vizite apo çështje tjera ku përfshihen paraqitja e dokumenteve që kanë të bëjnë me tatimet;
- Të ju këshillojë për qëllimin e vizitës dhe kërkesave tona;
- Të aranzhojë një kohë dhe vend të përshtatshëm për takim dhe do t'u jap kohë në mënyrë që ju të përgatitni dokumentet e nevojshme;
- Të kërkojë qasje në informatat të cilat janë relevante vetëm për kërkesat tatimore.
- Të ruaj konfidencialitetin e të dhënave tuaja dhe do të përdor këto të dhëna brenda administratës tatimore dhe vetëm në masën e kërkuar për administrimin e tatimeve.

Nëse besoni se kjo e drejtë e juaja nuk është respektuar, ju inkurajojmë të kontaktoni Zyrën për Standarde Profesionale të ATK-së:

E-mail: standardet.profesionale@atk-ks.org
Tel: +381 38 200 250 46

3. E drejta për t'u ankuar

ATK do të mundohet që:

- Plotësisht t'u sqarojë të drejtat tuaja për shqyrtim, kundërshtim dhe ankesë, nëse ju nuk keni informata të mjaftueshme, apo keni nevojë për sqarime;
- Të rishikojë rastin tuaj, nëse ju besoni se janë keqinterpretuar faktet tuaja, se është aplikuar ligji në mënyrë jo korrekte apo nuk është trajtuar rasti juaj ashtu siç do të duhej;
- T'u sigurojë se shqyrtimi është kryer në mënyrë gjithëpërfshirëse, profesionale dhe të paanshme. Kjo do të bëhet nga përfaqësuesi i cili nuk është i përfshirë në vendimin origjinal;
- Të kërkojmë informata shtesë nga ju, kur është e nevojshme për të zgjidhur çështjen në kontest;
- Të përcaktojmë kundërshtimin tuaj brenda afatit 60 ditor²
- T'u japim arsyet nëse kundërshtimi juaj është pranuar, anuluar pjesërisht apo refuzuar

Nëse besoni se kjo e drejtë e juaja nuk është respektuar, ju inkurajojmë të kontaktoni Avokatin e Tatimpaguesve:

E-mail: avokatitativpaguesve@atk-ks.org
Tel: +381 38 200 347 09

²Nëse Departamenti i Ankesave konstaton se nevojiten informata shtesë si nga ATK apo nga Tatimpaguesi, periudha kohore për të marrë një vendim për rastin suspendohet nga koha kur DA kërkon informata shtesë derisa informatat të jenë pranuar në DA.

1. Obligimi për të qenë i sigurtë dhe bashkëpunues

ATK pret nga ju që:

- Të jepni informata komplete dhe të sakta, në momentet kur ato kërkohen;
- Të deklaroni të gjitha të ardhurat tuaja të tatueshme në deklaratat tatimore;
- T'u përgjigjeni pyetjeve të bëra nga ATK plotësisht, saktësisht dhe sinqerisht;
- Të sqaroni faktet dhe rrethanat, kur ju kërkoni këshillë tatimore apo kur ju kërkoni vendim individual shpjegues;
- Të bashkëpunoni me zyrtarët tatimor dhe t'i trajtoni ata me mirësjellje dhe respekt, ashtu siç ata bëjnë kur merren me ju.

2. Obligimi për të dhënë informata dhe për të mbajtur shënime të sakta në kohë të duhur

ATK pret nga ju që të:

- Plotësoni saktësisht deklaratat dhe dokumentet në afatet e caktuara kohore;
- Të jeni të kujdesshëm gjatë përgatitjes së dokumenteve tatimore;
- Të informoni ATK-në për ndodhitë relevante në mënyrë që të menaxhoj legjislacionin tatimor në mënyrë të duhur dhe të efektshme, dhe atë në rastet si:
 - ▶ Hapje të biznesit
 - ▶ Ndërrimin e adresës korrespondente
 - ▶ Ndërrimin e vendit të biznesit, si dhe
 - ▶ Ndërrprerjen e biznesit
 - ▶ Të tjera
- Mbani shënime të mjaftueshme dhe libra, për të bërë të mundshme kryerjen e obligimeve tuaja tatimore;
- Mbani shënime të mjaftueshme dhe libra për periudhën e nevojshme mbajtëse;
- Keni kujdes të mjaftueshëm në përgatitjen e shënimeve, librave apo dokumenteve tjera tatimore;
- Na lejoni neve që të kemi qasje në shënime dhe librat tuaja, ashtu që ne të mund t'i kontrollojmë obligimet tuaja tatimore.